



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr.14805Prot.

Lezhë, më 22.08.2025

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
KATEGORIA EKZEKUTIVE**

**Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomik/ Financë”
Niveli minimal i diplomës “Bachelor”**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, Bashkia Lezhë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimin në shërbimin civil, Udhërit nr.3 datë 06.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimet e pozicioneve, klasat për çdo pozicion pune për administratën e bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve vartëse dhe të punonjësve të njësive të shërbimeve për vitin 2025”, i ndryshuar, Planit të Pranimeve në Shërbimin Civil të vitit 2025, miratuar me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.153, datë 04.03.2025, Bashkia Lezhë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimin në shërbimin civil, kategoria ekzekutive, i ndryshuar, për pozicionin:

- 1. Specialist për Magazinën dhe Inventaret, Sektori i Kontabilitetit, Drejtoria e Finances dhe Buxhetit, Bashkia Lezhë-kategoria IV-2.**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil.

**Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil)
aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e Dokumenteve: Lëvizje paralele	01.09.2025
--	-------------------

Afati për dorëzimin e Dokumenteve: Pranim në shërbimin civil	08.09.2025
---	-------------------

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Ndjek dhe kontrollon mirëadministrimin e pasurisë së institucionit, inventarizimin saj dhe bën sistemimin e diferencave sipas legjislacionit në fuqi.
- Kontrollon magazinën dhe lëvizjet e vlerave monetare dhe materialeve në përputhje me dokumentacionin përkatës dhe me legjislacionin në fuqi.
- Kontabilizon në ditar hyrjet dhe daljet e magaziës
- Ndjekja dhe kontrolli i magazinës industriale dhe asaj ushqimore.
- Kontabilizimi në sistemin Alpha i hyrjeve dhe daljeve të magazinës
- Ndjekja dhe rregjistrimi i hyrjeve dhe daljeve të karburantit.
- Kontrollon justifikimet e konsumit të karburantit nga automjetet që janë në pronësi të Bashkisë.
- Rekordimin për gjendjen e magazinave çdo fund muaj me magazinieret përkatës.
- Ngritja e urdherave për vlerësimin dhe miratimin e vlerës për materialet e rezultuar jashtë përdorim nga inventarizimi i aseteve në pronësi të Bashkisë .
- Hedhja e faturave me flete hyrje në sistemin ALPHA
- Mbajtja dhe perditesim i ditarit të magazines per hyrje dhe daljet.
- Ndjekja dhe zbatimi i procesit të inventarizimit fizik të aseteve në pronësi të bashkisë.
- Inventarizimi fizik dhe kontabel i aseteve në pronësi të Bashkisë.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori, (sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar)(niveli i pagës IV-2),
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt);

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në degen Ekonomik/ Finance edhe diploma bachelor në të njejten fushe (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- c) Të ketë eksperience punë mbi 1 vit në administratën shtetërore ose vendore në profesion.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Lezhë, dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 01.09.2025.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **04.09.2025** njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Lezhë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën paraprake të kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- e) Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
- f) Njohuritë mbi Ligjin nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.
- g) Njohuritë mbi ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- h) Njohuritë mbi ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- i) Njohuritë mbi Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Lezhë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- Pranimi në shërbimin civil

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunesit civil”, i ndryshuar.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimi në shërbimin civil janë:

- d) Të jetë shtetas shqiptar;
- e) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- f) Të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- g) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- h) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- i) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në degen Ekonomik/ Finance, edhe (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislationit në fuqi).
- b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- c) Të ketë eksperience punë mbi 1 vit në administratën shtetërore ose vendore në profesion.

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);

- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësime pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 08.09.2025, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Lezhë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **18.09.2025**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Lezhë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- f) Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- g) Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- h) Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
- i) Njohuritë mbi Ligjin nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

- j) Njohuritë mbi ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- k) Njohuritë mbi ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- l) Njohuritë mbi Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al)

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Lezhë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e saj zyrtare. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi në Shërbim Civil në kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e internetit të Bashkisë Lezhë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure duke filluar nga data **18.09.2025**

KRYETARI
Pjerin Ndreu